



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:241935  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05721536

**Ac.nr.8065/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Kujtim Pasuli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit D. Q. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson nëna e tij përfaqësuesja ligjore L. Sh. nga Prizreni, kundër debitorit të përmbartimit M. Q. nga Prizreni, për shkak të përmbartimit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.45/10 të datës 02.04.2010, përkatësisht detyrimit në të holla në emër të alimentacionit dhe i lejuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.1525/2011 të datës 10.08.2011, duke vendosur sipas ankesës të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP.nr.1525/2011 të datës 26.10.2022, me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e debitorit M. Q. nga Prizreni, **ANULOHET** në tërësi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren CP.nr.1525/2011 të datës 26.10.2022.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e goditur nën I të dispozitivit shqiptohet gjoba në të holla në shumë prej 300,00€, kundër debitorit M. Q. nga Prizreni, për shkak të mosrespektimit të aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit të formës së prerë E.nr.1525/11 të datës 10.08.2011. Nën II të dispozitivit debitori M. Q. nga Prizreni, obligohet që gjobën e shqiptuar, ta paguaj brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës-Gjykata Themelore në Prizren, nën kërcënimin e përmbartimit me detyrim. Nën III të dispozitivit gjoba në të holla e shqiptuar, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi do të shqiptohet në mënyrë të përsëritur nëse debitori i përmbartimit, nuk vepron sipas aktvendimit të gjykatës apo vazhdon në kundërshtim me këtë aktvendim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori M. Q., ka parashtruar ankesë, për shkak të:

- shkeljes thelbësore të dispozitave të LPK-ë,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe
- Të parashkrimit të lëndës, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktvendimin e goditur ta ndryshoj dhe ta liroj nga pagimi i gjobës ose të abrogoj dhe lëndën ta kthej në rigjykim e rivendosje, organit të shkallës së parë..

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 lidhur me nenin 208 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, ka vlerësuar aktvendimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 e 2 të LPK-së dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se është në zhvillim procedura përmbarrimore, përkatësisht çështja përmbarrimore e kreditorit dhe debitorit dhe se gjykata e shkallës së parë ka marrë aktvendimin CP.nr.1525/2011 të datës 26.10.2022, për shqiptimin e gjobës në shumë prej 300,00€ kundër debitorit, për shkak të mosrespektimit të aktvendimit mbi caktimin e përmbarrimit të formës së prerë E.nr.1525/2011 të datës 10.08.2011.

Gjykata e shkallës së parë, aktvendimin e goditur ka marrë duke gjetur se ka mbajtur disa seanca dëgjimore-gjyqësore, ndërsa në seancën e datës 26.07.2022, është urdhëruar debitori i përmbarrimit që të përmbush detyrimin në të holla për pagesën e alimentacionit sipas aktgjykimit i cili është dokument përmbarrimor, e në të kundërtën gjykata ndaj palës debitorë do të shqiptoj gjoba të parapara sipas LPP-së, mirëpo pala debitorë edhe pse është urdhëruar të përmbush detyrimin ndaj palës kreditore, por deri më tani kjo gjykatë nuk ka prova se pala debitorë e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj palës kreditore, andaj ka vendos që ndaj palës debitorë ti shqiptohet gjoba për shkak të mosrespektimit të aktvendimit të gjykatës E.nr.1525/2011 të datës 10.08.2011, me të cilin është lejuar përmbarrimi dhe se kjo gjykatë, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës, ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 15 lidhur me nenin 293 të LPP-së, që kundër debitorit të përmbarrimit M. Q. nga Prizreni, ti shqiptohet gjoba në të holla në shumën e lartcekur.

Pran një gjendje të tillë të çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës, ka konstatuar se aktvendimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i), e lidhur me nenin 17 të LPP, në të cilën me të drejtë tregohet në ankesën e debitorit. Kjo për faktin se me shikimin në shkresat e lëndës rezulton se ftesa për seancë të datës 26.07.2022 si dhe procesverbali i datës 26.07.2022, nga ana e gjykatës nuk është dorëzuar debitorit në kuptim të dispozitave të LPK-së, konkretisht të neneve 110 dhe 111. Sipas dispozitës së nenit 110 të LPK-së ftesa dhe procesverbali i dorëzohet personalisht palës. Me shikimin në fletë dërgesat për dorëzim personal që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se ftesa dhe procesverbali ku është marrë aktvendimi është dorëzuar vëllait të debitorit dhe një dorëzim i këtillë është në kundërshtim me nenin 110.2 të LPK-së, ku theksohet po qese personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës personalisht nuk gjendet në banesën e vetë, dorëzuesi duhet të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 par.1 dhe 2 të

këtij Ligji, njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe orën e caktuar në banesën e vetë. Neni 110.3 të LPK-së, parashihet po qese edhe pas kësaj dorëzuesi i shkresës nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresa, atëherë ai do të veproj sipas dispozitave të nenit 111 të këtij Ligji, dhe kështu dorëzimi duhet të konsiderohet i kryer. Prandaj, me të drejtë debitori në ankesën e vet thekson se ftesën dhe procesverbalin nuk e ka pranuar personalisht, e që u vërtetua nga fletë dërgesat për dorëzim personale, andaj edhe vendimi i goditur detyrimisht është dashur të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë do të ketë parasysh të cekurat si më lartë, ftesën për seancë do t'ia dërgoj dhe do ta dorëzoj personalisht debitorit dhe pastaj do ta mban seancë ku do të urdhëroj të veproj sipas aktvendimit për përmbarim, e nëse nuk vepron, atëherë mund t'ia shqiptoj dënimin me gjobë.

Prandaj, Gjykata e Apelit e Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 209 par. 1 pika d) të LPK-së, dhe nenit 3 par. 2 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8065/2022, të datës 21.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Kujtim Pasuli**